



## Zbulimi i hershëm përmes mamografisë

Të zbulohet me kohë kanceri i gjirit –  
Të përmirësohen shanset për shërim

**swiss  
cancer  
screening**

Schweizerischer Verband der Krebs-Früherkennungsprogramme  
Fédération suisse des programmes de dépistage du cancer  
Federazione svizzera dei programmi di screening del cancro

## Përmbajtja

- 03 Ekspertet dhe ekspertët në programin e zbulimit të hershëm rekomandojnë mamografinë
- 04 Ç'është mamografia?
- 05 Ç'do të thotë kontroll i zbulimit të hershëm?  
Ç'do të thotë program për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit?
- 06 Sa kushton një mamografi në programin e zbulimit të hershëm?  
Kush mund të marrë pjesë në këtë program të zbulimit të hershëm?
- 07 Si duhet përgatitur për një kontroll mamografie?
- 09 Si rrjedh një kontroll mamografie?  
Kur dhe si do të kumtohet rezultati i kontrollit?
- 10 Rezultatet e femrave të kontrolluara në kuadrin e një programi të zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit
- 11 Kur duhen bërë sqarime të mëtejshme?  
Kush i paguan sqarimet e mëtejshme?  
Ç'ndodh nëse konstatohet kanceri i gjirit?
- 12 Cilat janë përparësitë dhe të mirat, të këqijat dhe rreziqet e një mamografie në kuadër të një programi të zbulimit të hershëm?
- 16 Çfarë duhet të dini lidhur me kancerin e gjirit?
- 17 Shkurtimisht
- 18 Terminologjia profesionale
- 19 Kontakte dhe informacione që ju ndihmojnë më tej

# Ekspertet dhe ekspertët në programin e zbulimit të hershëm rekomandojnë mamografinë

Mamografia është një metodë e përshtatshme për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Shoqata zvicerane swiss cancer screening, Enti federal për shëndetësi, Lidhja Zvicerane e Kancerit si dhe eksperte dhe ekspertë brenda dhe jashtë vendit, femrave të moshës 50 vjeçe e sipër u rekomandojnë që në kuadër të një programi me cilësi të kontrolluar mbi zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit ta bëjnë mamografinë çdo dy vjet. Dobia nga një kontroll për zbulimin e hershëm i tejkalon rreziqet.

Pjesëmarrja në kontrollin mamografik është vullnetare. Me këtë broshurë ne duam t'ju informojmë mbi përparësitë dhe të metat. Prandaj lexojeni me kujdes të tërën. Terminologjia shkencore është sqaruar në faqen 18. Është me rëndësi që të informoheni mirë dhe që vetë të vendosni mbi pjesëmarrjen e mundshme.

Në rast se keni pyetje të tjera, merrni kontakt me programin e zbulimit të hershëm në kantonin tuaj.



## Ç'është mamografia?

Mamografia është një radiografi speciale e krahavorit. Në një mamografi bëhen të dukshëm, madje, edhe tumorët më të vegjël, shumë përpara se të jenë të ndjeshëm me të prekur ose të njihen nga simptoma të tjera.

## Ç'do të thotë kontroll i zbulimit të hershëm?

Shpeshherë sëmundje të caktuara në fillim nuk ndjehen. Për këtë arsye, për sëmundje të tilla ekzistojnë kontrolle mjekësore të cilat – po të zbatohen rregullisht, – mund të përcaktojnë me kohë ndryshimet në organizëm. Kontrolle të tilla quhen kontrolle të zbulimit të hershëm. Qëllimi i tyre është që një sëmundje të zbulohet qysh herët me qëllim që ajo të mund të trajtohet me efektivitet të plotë dhe me sa më pak pasoja. Kontrollet për zbulimin e kancerit në qafën e mitrës si dhe radiografitë e kraharrorit (mamografitë) për zbulimin e kancerit të gjirit janë dy shembuj për kontrolle të tilla të zbulimit të hershëm. Kontrollet e zbulimit të hershëm bëhen në mënyrë individuale ose në kuadër të një programi që u referohet grupeve të caktuara të popullsisë.

## Ç'do të thotë program për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit?

**Një program për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, femrave nga 50 vjeçe e sipër u ofron çdo dy vjet realizimin e një mamografie. Shpenzimet për këtë kontroll në pjesën më të madhe mbuloohen nga sigurimi bazë shëndetësor.**

Mamografia në kuadër të një programi vlen si një masë e njohur shkencërisht dhe e rekomanduar nga shumë ekspertë dhe organizata përkatëse për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Ky implementim sistematik quhet ndryshe edhe Mammografie-Screening. Përmes kontrolleve të tilla të rregullta mund të shtohen shanset për shërim dhe jetëgjatësi të femrave me kancer gjiri.

Programet sistematike u nënshtrohen normave të larta të cilësisë të cilat vazhdimisht verifikohen dhe perfeksionohen. Kësisoj, grafitë e përfituara gjykohen prej dy radiologëve/radiologeve me trajnime speciale përkatëse, pavarësisht nga njëri-tjetri. Edhe aparaturat, me të cilat sigurohen imazhet, u nënshtrohen kontrolleve të rrepta cilësore. Mamografitë realizohen vetëm nëpër institute të licencuara rëntgenologjike përmes specialistëve me kualifikim special për radiologji teknike medicinale.

Në Zvicër kantone të ndryshme zbatojnë programe mbi zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Për pyetje të rastit janë në dispozicion Programi kantonal për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, Telefoni i kancerit, Lidhjet kantonale të kancerit ose mjekët dhe mjeket e përfshira në trajtim.

## Sa kushton një mamografi në programin e zbulimit të hershëm?

Sigurimi bazë shëndetësor i paguan shpenzimet e kontrollit në shumën prej 200 frangash, pa ua llogaritur në franshisë.

Ju vetë duhet t'i paguani vetëm 10 për qind të shpenzimeve të kontrollit (dmth rreth. 20 franga). Në disa kantone, madje, shpenzimet mbulohen tërësisht. Informacione për këtë mund të merrni në programin e zbulimit të hershëm të kantonit tuaj.

## Kush mund të marrë pjesë në këtë program të zbulimit të hershëm?

Të gjitha femrat nga 50 vjeçe e sipër, që banojnë në një kanton ku zbatohet një program i zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit, kanë të drejtë të marrin pjesë në të, pavarësisht nga nacionaliteti dhe nga statusi i qëndrimit. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë edhe banorët e zonës kufitare me një sigurim të kontraktuar në Zvicër.

Ju do të merrni çdo dy vjet, deri në moshën 70-vjeçare, përkatësisht, në disa kantone deri në moshën 74-vjeçare, një ftesë personale me shkrim për mamografi me informacione udhërrëfyese nga programi i kantonit tuaj. Disa programe në ftesë propozojnë një afat konkret vizite, të tjerat ju informojnë se si mund ta caktoni me marrëveshje një afat kontrolli.

Ju vendosni vetë nëse dëshironi ta realizoni kontrollin. Pjesëmarrja në programin për zbulimin e hershëm është vullnetare.

## **Ç'duhet bërë nëse ...?**

### **...keni konstatuar tashmë ndryshime në kraharorin tuaj?**

Atëherë mos e prisni ftesën nga programi i juaj i zbulimit të hershëm, por shkoni direkt te mjeku i juaj/mjekja e juaj.

### **...tashmë keni pasur kancer gjiri?**

Në këtë rast informohuni te mjeku ose te mjekja juaj për faktin se cilat kontrolle do të ishin më të mira për ju.

### **...nëna, motra ose vajza juaj janë të sëmura nga kanceri i gjirit?**

Atëherë duhet të këshilloheni nga mjeku i juaj/mjekja e juaj, ose t'i drejtoheni një programi përgjegjës të zbulimit të hershëm.

### **...keni një protezë gjiri?**

Atëherë duhet të këshilloheni nga mjeku i juaj/mjekja e juaj, ose t'i drejtoheni një programi përgjegjës të zbulimit të hershëm.

### **...jeni më e re se 50 vjeçe dhe ju preokupon kjo temë?**

Atëherë ju rekomandojmë që të bisedoni për këtë me mjekun/me mjeken tuaj.

## **Si duhet përgatitur për një kontroll mamografie?**

- Zgjedhja e orarit të vizitës: po të keni akoma menstruacione të rregullta, atëherë orarin tuaj për kontroll mamografik duhet ta caktoni në ditët pas fillimit të ciklit menstrual. Në këtë kohë gjinjtë tuaj janë më pak të ndjeshëm.
- Në rast se doni të trajtoheni nga një specialiste femër, theksojeni këtë medoemos përpara caktimit të orarit.
- Nëse lëvizni me karrocë me rrota, komunikojeni këtë fakt gjatë përcaktimit të afatit, me qëllim që për ju të jetë gjithçka gati.
- Bashkë me ftesën ju do të merrni edhe një pyetësor për gjendjen tuaj shëndetësore. Plotësojeni atë dhe merreni me vete ditën e kontrollit.

### **Ditën e kontrollit:**

- Vishni ndonjë rrobë që mund ta zhvishni me lehtësi, ngaqë radiografia e kraharorit bëhet me trupin zhveshur nga mesi e lart.
- Nuk duhet të vini deodoransë, pluhura, losione ose parfumëra, as në gjinj dhe as nën sqetulla me qëllim që të mos cenohet cilësia e radiografisë.
- Para kontrollit mos vini stoli në pjesën e sipërme (si gjerdanë, e të ngjashme).



**Incizimet mamografike  
i realizojnë personat me  
arsim të specializuar.**



## Si rrjedh një kontroll mamografie?


- Kontrolli rëntgenologjik nuk zgjat më shumë se disa minuta, megjithatë planifikoni gjithsej 20 deri 30 minuta.
- Gjatë kësaj kohe do të përkujdeseni personalisht prej një specialisti me kualifikim special, i cili do të krijojë edhe imazhet.
- Për realizimin e radiografive duhet të zhvisheni nga mesi e lart.
- Për të fituar një pamje optimale, dhe që doza e rrezatimit të mbetet e ulët, secili nga gjinjtë do të shtrëngohet midis dy pllakash për disa sekonda. Ky çast, prandaj, mund të duket i pakëndshëm, mirëpo nuk zgjat shumë.
- Radiografitë do të gjykohen nga së paku dy radiologë, pavarësisht nga njëri-tjetri. Për këtë arsye, në çastin e kontrollit nuk do të ketë as biseda me ndonjë mjek ose mjeke.

## Kur dhe si do të kumtohet rezultati i kontrollit?

- Ju do të njoftoheni për rezultatin me shkrim brenda tetë ditëve të punës. Kaq kohë u duhet radiologeve dhe radiologëve për të vlerësuar me kujdes imazhet. Nëse gjatë kësaj kohe do të ndjeni ndonjë pasiguri ose ankth, flisni hapur për këtë fakt me bashkëpunëtorët e programit tuaj të zbulimit të hershëm ose me mjeken apo mjekun tuaj.
- Nëse në pyetësin e plotësuar keni rënë dakord, rezultati do t'i kumtohet edhe mjekut ose mjekes tuaj.

# Rezultatet e femrave të kontrolluara në kuadrin e një programi të zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit

Skema e mëposhtme tregon rezultatet e 1000 femrave që kanë marrë pjesë në pesë runde mamografie brenda 10 vitesh:



Nga faktet rezulton se në grupin e «femrave me mamografi» mund të parandalohet një rast vdekjeje nga kanceri i gjirit. Në afro 4 nga gjithsej 24 diagnostikime me kancer gjiri bëhet fjalë për të ashtuquajturat mbidiagnoza (shiko faqen 15). Për një femër që pas moshës 50-vjeçare merr pjesë rregullisht në mamografi, ekziston rreziku prej afro 1 për qind që gjatë jetës së saj të mbi-diagnostikohet dhe përkatësisht të trajtohet.

## Kur duhen bërë sqarime të mëtejshme?

- Nëse në një mamografi do të konstatohen shfaqje të pazakonta, duhen ndërmarrë disa sqarime me qëllim që të kuptohet lloji i ndryshimit. Kjo ndodh në rreth 4 deri 5 për qind të rasteve të mamografive të realizuara.
- Nëse e keni nënvizuar në pyetësorin shëndetësor, mbi rezultatin do të informohet edhe mjeku ose mjekja e juaj dhe do të marrë një rekomandim lidhur me llojin e sqarimit. Kryesisht do të rekomandohet ultratingulli ose incizime të reja rëntgenologjike.
- Do të merrni gjithashtu rekomandimin që të merrni kontakt me mjekun ose mjeken tuaj. Ai/ajo do t'ju këshillojë dhe do t'ju orientojë për hapat e domosdoshëm.
- Në shumicën e rasteve bëhet fjalë për ndryshime natyrë-mirë, ndërkaq, ju do të ftoheni për mamografi të zbulimit të hershëm deri sa të arrini kufirin e caktuar të moshës për çdo dy vjet.

## Kush i paguan sqarimet e mëtejshme?

Shpenzimet për sqarimet e mëtejshme merren përsipër prej sigurimit bazë shëndetësor. Ndërkaq franshisën dhe vetëkontributin duhet t'i paguani vetë.

## Ç'ndodh nëse konstatohet kanceri i gjirit?

Në 0,5–1 për qind të mamografive të realizuara diagnostikohet një kancer gjiri.

Po të jetë konstatuar kanceri i gjirit, mjeku ose mjekja juaj do të bisedojë me ju hollësisht për procedurën e mëtejshme. Ju do të përkujdeseni prej një ekipi specialistesh dhe specialistësh të ndryshëm me qëllim të përcaktimit të një trajtimi më të mirë të mundshëm.

## Cilat janë përparësitë dhe të mirat, të këqijat dhe rreziqet e një mamografie në kuadër të një programi të zbulimit të hershëm?

Ashtu si në të gjitha kontrollet tjera mjekësore, edhe në rastin e mamografisë në kuadër të një programi të zbulimit të hershëm duhet bërë dallimi midis përparësive dhe dobive, të këqijave dhe rreziqeve. Shumica e eksperteve dhe ekspertëve pajtohen që dobia prej saj ngre peshë më shumë se sa rreziqet. Kjo është vërtetuar nga një hulumtim i pavarur në Britani dhe nga një analizë e realizuar për 25 vjet Mammografie-Screening në Holandë. Përvojat nga vendet tjera fqinje, të cilat ofrojnë programe të tilla që prej vitesh, gjithashtu i kanë vërtetuar këto rezultate.

Te një femër 50 vjeçe e sipër si faktor rrezikues më i madh për shfaqjen e kancerit të gjirit vlen mosha.

Kontrolli i zbulimit të hershëm nuk e eviton dot kancerin e gjirit.

Me pjesëmarrjen në një program të zbulimit të hershëm ju do të shfrytëzoni rastin për një zbulim të hershëm të kancerit të gjirit dhe kështu për mundësi trajtimi efektiv dhe me më pak pasoja. Kjo ndihmon në cilësinë më të mirë të jetës suaj dhe mund ta zgjasë atë.

Ndërkaq ju do të rrezikoni me faktin se mund t'ju diagnostikohet ndonjë kancer natyrëkeq i cili mbase nuk do të luante ndonjë rol gjatë jetës suaj (mbidiagnoza). Ndërkaq, mjekësia e sotme nuk është në gjendje ta parashikojë mënyrën e sjelljes së tumorëve. Për këtë shkak, nën trajtim do të merren të gjithë tumorët e gjinjve të zbuluar përmes mamografisë.

Është me rëndësi që ndryshimet në gjinjtë tuaj t'i merrni kurdoherë seriozisht dhe të vizitoni një mjekë ose një mjek.

## Përparësitë dhe dobia

**Zbulimi i hershëm:** Përmes një mamografie të një programi të zbulimit të hershëm mund të zbulohen madje edhe tumorët më të vegjël, që kryesisht akoma nuk kanë krijuar metastaza. Përmes zbulimit të hershëm dhe trajtimit të tij përmirësohen shanset për mbijetesë dhe për shërim.

**Cilësi më e mirë jetese përmes trajtimeve me më pak pasoja dhe më efektive:** përmes zbulimit të hershëm të tumoreve femrat mund të trajtohen në mënyrë të kursyer. Kështu p.sh. mund të operohen pa humbur gjirin, ndërsa pjesërisht mund të hiqet dorë edhe nga kimioterapia. Kësisoj do të reduktohen ndikimet anësore dhe do të shtohet cilësia e jetesës – si gjatë fazës së sëmundjes, ashtu edhe më pas.

**Kontribut në uljen e vdekshmërisë në rastin e kancerit të gjirit:** zbulimi i hershëm dhe mundësitë e përmirësuara të trajtimit bashkë-ndihmojnë që tek femrat e kësaj grupmoshe shkalla e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit të ulet. Në Zvicër, në grupmoshën mbi 50 vjeç, nga kanceri i gjirit vdesin afro 1250 femra në vit. Femrat që vdesin midis moshës 50–70 vjeçe, humbin rreth 4200 vite të mundshme të jetës. Një femër që pas moshës 50-vjeçare merr pjesë në një program të zbulimit të hershëm për çdo dy vjet, zvogëlon ndjeshëm rrezikun e saj për të vdekur nga kanceri i gjirit.

**Qetësimi:** 95 për qind e femrave të kontrolluara mund të qetësohen, duke qenë se rezultatet e mamografisë nuk do të tregojnë shfaqje shqetësuese.

**Cilësia e lartë në program:** Me pjesëmarrjen në një program të zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit femrat përfitojnë ngase cilësia e kontrollit e realizuar sipas standardeve të përcaktuara verifikohet dhe dëshmohet rregullisht.

## Cilësia

Femrat që marrin pjesë në një program të zbulimit të hershëm përfitojnë nga një cilësi e lartë e garantuar:

- Programet bazohen në kritere të larta kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë;
- aparaturat rëntgenologjike kontrollohen rregullisht për sa i përket përmbushjes së kritereve të larta të cilësisë;
- secili specialist i radiologjisë teknike dhe medicinale ka absolvuar një kualifikim plotësues për realizimin e një Mamografie-Screening;
- kualiteti i fotografive të realizuara verifikohet rregullisht;
- pamjet e incizuara gjykohen prej dy radiologëve me arsim special, pavarësisht nga njëri-tjetri;
- në rast rezultatesh të kundërta, fotografitë rivlerësohen, ose në kuadër të një konference konsensuale prej shumë radiologeve/radiologëve së bashku, ose me përfshirjen e një radiologeje, radiologu të tretë;
- përmes verifikimeve dhe matjes sistematike të rezultateve (evaluacionit) kualiteti i programeve zhvillohet vazhdimisht më tej.

Në rast kontrolli jashtë programeve kantonale të zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit, kualiteti nuk është transparent dhe nuk matet dot. Përpos kësaj, shpenzimet e kontrollit nuk mbulohen nga sigurimi bazë shëndetësor dhe nuk janë të lira nga franshisa.



## Të këqijat dhe rreziqet

**Mbidiagnoza:** Me këtë nënkuptohen tumorët natyrëkeq, të cilët as që do të zbuloheshin ndonjëherë pa një mamografi, dhe për këtë shkak, për femrën e prekur realisht nuk do të kishin rëndësi. Duke qenë se në çastin e diagnostikimit të tumorit natyrëkeq nuk mund të dihet se si do të zhvillohet ai më tej dhe nëse do të shkaktojë ose jo probleme shëndetësore, normalisht pason trajtimi kundër kancerit të gjirit. (Sa i përket nocionit «Mbidiagnostikim» është fjala për një vëzhgim thjesht statistikor).

**Rezultatet e gabuara pozitive ose negative:** Po të zbulohen shfaqje të pazakonshme gjatë mamografisë, që të mund të konstatohet lloji i ndryshimit duhen zhvilluar sqarime të tjera. Në shumicën e rasteve, ndërkaq, këto ndryshime rezultojnë si natyrë-mirë dhe nuk bëhet fjalë për kancer gjiri. Në këtë rast bëhet fjalë për **rezultate të gabuara pozitive**.

**Kanceri i intervalit dhe rezultatet e gabuara negative:** Në rastin e kancerit të intervalit bëhet fjalë për një kancer gjiri i cili zbulohet në dy vitet midis kontrolleve mamografike. Nëse mamografia do të gjykohet si joshqetësuese, ndonëse kemi prani të kancerit të gjirit, do të flitet për **rezultate të gabuara negative**.

**Pas zbulimit rrjedha e sëmundjes nuk mund të ndikohet më:** Ka mundësi që gjatë kontrollit mamografik tumori të zbulohet në një stad në të cilin shërimi tashmë është i pamundur. Në këtë rast, femrat e prekura do të jetojnë gjatë duke qenë të vetëdijshme për sëmundjen që kanë.

**Shkalla e ngarkesës rrezatuese gjatë radiografisë:** Shkalla e rrezatimit, falë përdorimit të aparateve rëntgenologjike të cilësisë së mirë dhe falë kontrolleve të parashkruara me ligj, është tejet e ulët. Ky rrezik te femrat mbi 50-vjeçare vlerësohet ndjeshëm më i ulët se sa dobia nga kontrolli mamografik.


## Çfarë duhet të dini lidhur me kancerin e gjirit?

Në Zvicër kanceri i gjirit është sëmundja më e shpeshtë kanceroze dhe shkaktari numër një i vdekjes tek femrat midis moshës 50 dhe 70 vjeçe. Për çdo vjet nga kjo sëmundje preken mbi 5400 femra, ndërsa 1350 syresh vdesin prej saj.

Shanset për mbijetesë dhe shërim nga kanceri i gjirit janë qartazi më të mëdha në rast se zbulohet më herët dhe në rast se trajtohet mirë. Studimet ndërkombëtare tregojnë se përmes kontrolleve të rregullta në kuadër të një programi të zbulimit të hershëm me cilësi të kontrolluar, shumë femra mund të shërohen nga sëmundja. Pos kësaj, zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit mundëson shpesh trajtime që kursejnë organet, është me efekte anësore më të ulëta, dhe kësajsoj, me një cilësi jetese më të lartë.

### Incidenca e sëmundjeve të kancerit të gjirit në Zvicër sipas grupmoshave

---



Afro 80% e të gjitha sëmundjeve të kancerit të gjirit prekin femrat nga 50 vjeçe e sipër.



## Shkurtimisht

Secila femër e mirëinformuar vendos vetë në bazë të dobisë dhe rreziqeve nëse do të marrë pjesë ose jo.

Në vijim do t'i gjeni ato më të rëndësishmet shkurtimisht:

- Në stadin e tij fillestar kanceri nuk shfaq simptoma;
- investimi i kohës dhe shpenzimet për zbulimin e hershëm të kancerit janë të vogla;
- Kanceri i gjirit mund të shërohet, ndërsa shanset për mbijetesë mund të përmirësohen – përmes zbulimit të hershëm dhe trajtimit adekuat;
- Në një rast vdekjeje të evituar bien katër mbidiagnostikime (shiko faqet 10 dhe 15).

Pas moshës 50-vjeçare, nga programi i zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit në kantonin tuaj ju do të merrni çdo dy vjet një ftesë për realizimin e një mamografie me adresim personal.

Në kuadër të kontrollit të zbulimit të hershëm do të bëhen nga dy radiografi të gjinjve tuaj prej një personeli mjekësor profesional me arsim special.

Çdo radiografi do të gjykohet së paku prej dy radiologëve, pavarësisht nga njëri-tjetri.

Ju dhe mjeku ose mjekja e përzgjedhur prej jush do ta merrni rezultatin e kontrollit të kumtuar me shkrim më së voni pas tetë ditëve të punës.

Gjetjet e pazakonshme do të sqarohen në formë të thelluar.

**Kjo broshurë ju ndihmon që të vendosni pro ose kundër një pjesë-marrjeje në një program të zbulimit të hershëm. Nëse keni pyetje të tjera, programi i zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit nga kantoni i juaj, telefoni i kancerit, lidhjet kantonale të kancerit ose mjekja apo mjeku i juaj, do t'ju ofrojnë informacione të tjera.**

## Terminologjia profesionale

**Metastaza:** metastazat (ose bifkat) janë ngulime të një tumori në inde të largëta.

**Gjetje (rezultat):** njoftimi pas një kontrolli nëse ekziston ose jo një dyshim për kancer gjiri.

**Kimioterapia:** trajtim për shkatërrimin e qelizave kanceroze. Përmes medikamentesh të caktuara pengohet formimi i qelizave të reja kanceroze.

**Franshisa:** shpenzimet për mjekun, spitalin dhe medikamentet të cilat i siguruari duhet t'i paguajë vetë. Kontributi vjetor luhartet, sipas rastit, sipas modelit të përzgjedhur sigurimor, midis 300 dhe 2500 frangash.

**Kontrolli i zbulimit të hershëm:** kontrollet që kanë për qëllim zbulimin e hershëm të sëmundjeve, përpara se të shfaqen shenjat e sëmundjes.

**Mamografia:** radiografi e krahavorit.

**Ekspertë/-e tekniko-medicinale të radiologjisë:** profesionistë me arsim special që bëjnë incizime mamografike.

**Ndikime anësore:** ndikime të padëshirueshme që shfaqen gjatë përdorimit të një medikamenti ose trajtimi.

**Radiologe/radiolog:** mjek ose mjeke me arsim plotësues special (quhet dhe mjek i rëntgenit) që i diagnostikon sëmundjet me ndihmën e radiografive, ultratingullit etj.

**Screening:** fjalë angleze për kontrolle të zbulimit të hershëm, të cilat aplikohen në grupime popullore specifike.

**Ngarkesë rrezatimi:** masa e rrezeve rëntgen që depërtojnë në trup gjatë një kontrolli rëntgenologjik, në këtë rast, nga mamografia.

**Simptoma:** një shenjë që tregon praninë e një sëmundjeje ose lëndimi.

**Tumori:** e dalë në një organ. Ka tumore që përmbajnë qeliza kanceroze dhe ka të tillë pa to.

**Ultratingulli:** kontroll i cili mund të konstatojë ndryshime në një organ të trupit të njeriut me ndihmën e valëve zanore, në këtë rast, në indet e krahavorit.

# Kontakte dhe informacione që ju ndihmojnë më tej

swiss cancer screening disponon një ueb-faqe tregjuhëshe. Ueb-faqja përmban informacione të tjera dhe ju jep informacione lidhur me modalitetet për zbulim të hershëm në kantonin tuaj.

[www.swisscancerscreening.ch](http://www.swisscancerscreening.ch)

## Informacione të tjera për kancerin e gjirit në përgjithësi:

Organizatat në vijim angazhohen për një qasje të mirë ndaj zbulimit të hershëm të kancerit, trajtimit dhe pas-përkujdesjes ndaj tij:

Krebsliga Schweiz (Lidhja e kancerit Zvicër): [www.krebsliga.ch](http://www.krebsliga.ch),

Telefoni: 0800 11 88 11

Porosia e broshurave: 0844 85 00 00 ose [shop@krebsliga.ch](mailto:shop@krebsliga.ch)

Europa Donna Schweiz: [www.europadonna.ch](http://www.europadonna.ch)

---

Kjo broshurë u krijua me ndihmën profesionale dhe financiare të migesplus, në kuadër të programit nacional «Migracioni dhe shëndetësia 2008–2013» të Entit Federal për Shëndetësi.

Shkarkimi PDF nën [www.brust-screening.ch](http://www.brust-screening.ch) si dhe nën [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch) – Informacione shëndetësore në shumë gjuhë, Kryqi i Kuq Zvicëran.

---

## Impressum

Redaksia dhe botuesi: swiss cancer screening

Layouti dhe realizimi: durchzwei.ch

Broshura është testuar në grupimin të cilit i drejtohet

Burimet informative: Fleta faktografike e Lidhjes së Kancerit – Zvicër 7/2013; Direktivat evropiane për garanci cilësie në rastin e përkujdesjes dhe diagnostikimit të kancerit të gjirit, Edicioni i 4-të; Enti Federal për statistikë, incidencë dhe mortalitet kanceri 2006–2010, përditësuar më 27.06.2013; Paneli i pavarur i MB për radiografi të kancerit të gjirit, Përparësitë dhe rreziqet nga radiografia e kancerit të gjirit: revistë e pavarur, Lancet 2012; Këshilli shëndetësor i Holandës, Radiografimi i popullatës për kancer gjiri: pritmëritë dhe zhvillimet. Hagë: Këshilli shëndetësor i Holandës, 2014, publikacioni nr. 2014/01.

Kjo broshurë është në gjuhë të ndryshme; kontaktojeni programin tuaj të zbulimit të hershëm ose ueb-faqen e shoqatës.

Kjo broshurë ju dorëzohet përmes:



Kjo Broshurë informative ekziston ne gjuhë te ndryshme dhe mund te zhgarkohet falas nga faqja e Internetit (Webseite) [www.swisscancerscreening.ch](http://www.swisscancerscreening.ch):

 Gjermanisht

 Shqip

 Spanjisht

 Frëngjisht

 Maqedonisht

 Turqisht


 Italisht

 Portugalisht

   Serbisht-kroatisht-boshnjakisht

 Anglisht

 **swiss  
cancer  
screening**

 Schweizerischer Verband der Krebs-Früherkennungsprogramme  
Fédération suisse des programmes de dépistage du cancer  
Federazione svizzera dei programmi di screening del cancro

Postfach 8219, 3001 Bern, [www.swisscancerscreening.ch](http://www.swisscancerscreening.ch)